



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivery	08-06	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHAMSUK	4635/2023		.115	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.329/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.1355/2021 të datës 10.03.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.643/2019, të datës 22.10.2019, të parashtruar nga kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", mbështetur në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.643/2019 e datës 22.10.2019, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Njoftimi më numër protokolli 747 i datës 24.09.2019 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me kandidatin e suksesshëm për pozitën Zyrtar për Azil, në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan, Ministria e Punëve të Brendshme.

Arsyetim

Ministria e Punëve të Brendshme bazuar në Autorizimin e datës 20.08.2019, të Departamentit për Administrimit të Shërbimit Civil-Ministria e Administratës Publike, më datë 26.08.2019 ka shpallur Konkursin për pozitën *Zyrtar Për Azil* në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Me datë 24.09.2019 Ministria e Punëve të Brendshme ka publikuar Njoftimin me të cilin kandidatja është përzgjedhur si kandidate e suksesshme për pozitën Zyrtar Për Azil në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan.

E pakënaqur me këtë Njoftim ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin se ankuesja nuk është vlerësuar drejt dhe se kandidatja fituese nuk ka plotësuar kriteret për pozitën e punës Zyrtar Për Azil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, me datë 07.11.2019 ka udhëzuar ankuesen për inicim të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente. Ankuesja me datë 22.06.2021 ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me Aktgjykimin Anr.2781/19 të datës 16.04.2021 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën e datës 22.10.2019 të parashtruar nga ankuesja

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), me Vendimin A.nr. 329/2021 të datës 31.05.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 22.10.2019 duke lenë në fuqi Njoftimit me numër 747 të datës 24.09.2019, lidhur me kandidatin e suksesshëm për pozitën Zyrtar për Azil, në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan, Ministria e Punëve të Brendshme.

Ankuesja e pakënaqur me Vendim e Këshillit A.nr. 329/2021 të datës 31.05.2021, ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me aktgjykimin A.nr. 1355/2021 të datës 17.05.2023, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke e anuluar vendimin e Këshillit A.nr 329/2021 të datës 31.05.2021 dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4978/2019 të datës 22.10.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A. Nr.1355/2021 të datës 17.05.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A. Nr.2781/2019 të datës 16.04.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative Vendimin A. Nr. 329/2021, të datës 31.05.2021, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 24.09.2019, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm; Konkursin e datës 26.08.2019; Kërkesën për punësim të ankueses se bashku me shkresat e bashkangjitura: Vërtetim i datës 30.11.2014; Referencë e datës 16.05.2011; Diplomë e datës 28.12.2009; Diplomë e datës 21.07.2016; kërkesën për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 08.02.2013; Vërtetim i datës 28.08.2018; Vërtetim i datës 08.12.2016; Vërtetim i datës 15.05.2007; dëshmi nga trusti; Vendimi i datës 10.09.2019, për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Regjistrimin e Aplikacioneve të pranuar; testi me shkrim; Vlerësimi individual i Kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Përmbledhja e Vlerësimeve individuale; Raporti përmbyllës; Raporti Final i Rekomandimit; lista e ngushtë; Përgjigje në ankesë e datës 01.11.2019, me

numër protokolli 5141/2019, Kërkesën për punësim e _____ me shkresat e bashkangjitura; Diplomën e datës 17.11.2014; Diplomë e datës 21.06.2018; Vërtetimin e përvojës së punës i datës 23.02.2016; Kërkesën për punësim e _____ me shkresat e bashkangjitura; Referencën e datës 21.09.2017; Referencën e datës 03.08.2015; Vërtetimin e datës 13.12.2014; dëshminë-Pasqyra nga TRUST për periudhën 01.08.2020, deri me datë 23.08.2019; Kërkesën për punësim e _____ me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 22.02.2018; Raport për vlerësimin e punës, i vitit 2015; Kërkesën për punësim e _____ me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 30.03.2012; Diplomë e datës 19.01.1999; Vërtetim i datës 01.08.2012; Vërtetim i datës 28.03.2014; marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 01.07.2019; E- maili i datës 31.05.2021; e-maili i datës 25.05.2021, Njoftimi i datës 07.1.2019 i Këshillit; Përgjigje në ankesë e datës 26.05.202, kërkesa-emali i KPSHCK-së drejtuar ATK-së e datës 01.06.2023, emali-përgjigja nga ATK e datës 06.06.2023.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të Aktgjykimit A.Nr.1355/2021 të datës 17.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative dhe bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse,*

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja pretendon së Komisioni Përzgjedhës nuk ka vlerësuar me meritë dhe se në testin me shkrim i janë zbrit pikët, kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet për këtë pozitë, sepse e njëjta nuk ka kualifikim përkatës si dhe dy vjet përvoje pune pas diplomimit, në listë të ngushtë është përfshirë një kandidat nga Fushë Kosova i cili nuk ka plotësuar kushtet dhe se Raporti Final i Komisionit Përzgjedhës nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët. Mbi këtë bazë, ankuesja kërkon që Këshilli ta anuloj Njoftimin e datës 24.09.2019 lidhur me kandidatin e suksesshëm si dhe procedurën e rekrutimit për pozitën e Zyrtarit të Azilit, në Qendrën e Azilkërkuesve në Lipjan.

Sipas Autorizimit të DASHC-së të datës 20.08.2019 si dhe Konkursit të datës 26.08.2019, si kriteret të përcaktuar për pozitën e punës "Zyrtar Për Azil" në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan, kanë qenë: *Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, Shkenca shoqërore dhe minimumi dy (2) vite përvoje pune profesionale.*

Lidhur me pretendimin ankimor se ankuesja nuk është vlerësuar me meritë nga Komisioni Përzgjedhës dhe se në testin me shkrim i janë zbrit pikët, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesja është vlerësuar me gjithsej 67.5 %, ndërsa kandidatja e përzgjedhur është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë gjegjësisht me 75.5%. Ndërsa nga analizimi i testit të ankueses në raport me çelësin e testit, Kolegji nuk vëren ndonjë shmangie të vlerësimit të pikëve për ankuesen apo mbi vlerësim të kandidatës së përzgjedhur, andaj mbi bazën e këtij konstatimi, Kolegji vlerëson së Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civilë ku është përcaktuar se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kenë arritur numrin me të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe gojë.*

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankueses së kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet për këtë pozitë, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht dokumentacionit të dorëzuar me rastin e aplikimit ka gjetur së kandidatja posedon Diplomën Nr.491 të datës 08.02.2013, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet së _____ me datës 21.07.2012 ka mbaruar studimet themelore në Programin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, ndërsa sipas Vërtetimit me numër protokollit 565/2018 të datës 28.08.2018 të lëshuar nga ELKOS Group SHPK 02/284, me të cilin është konfirmuar së e njëjta ka punuar në pozitën e Arkëtares, ku bazuar në dëshminë e Trustit dhe konfirmimit të datës 06.06.2023 vërtetohet se ankuesja ka punuar pranë kësaj kompanie nga janari 2014 deri gusht 2016 pra gjithsej 29 muaj (2 vite e 5 muaj). Po ashtu bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se _____ ka punuar në Shkollën Filllore të Mesme Ulët "Skënderbeu" në fshatin Truboviq/Pejë, si mësimdhënësi për gjuhë dhe letërsi në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh si dhe Shkollën Filllore të Mesme Ulët "Ukshin Miftari" në fshatin Skivjan/Gjakovë në kohëzgjatje prej 3 muajsh, ndërsa periudha e punës në kompaninë "Trankos" sipas referencës nr.21.02.2017 nuk është marrë parasysh as me rastin në vendosjes sipas vendimit A.nr. 329/2021 të datës 31.05.2021, pasi që kjo përvojë pune nuk shoqërohet me konfirmim sipas pasqyrës së TRUST-it e as me konfirmim nga ATK-ja. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit dhe duke ju referuar pikëpamjeve e të gjykatës themelore Kolegji vlerëson së kandidatja e përzgjedhur ka plotësuar kushtin e arsimit pasi që fusha e studimeve përfshihet në grupin e shkencave shoqërore dhe së e njëjta ka mbi dy vite përvojë pune pas diplomimit.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor së në listën e ngushtë ka hyrë një kandidate nga Fushë Kosova e cila nuk ka plotësuar kushtet (*pa specifikuar të dhëna personale të kandidatës së aluduar*), Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës përkatësisht sipas Regjistrimit të Listës së shkurtër, ka gjetur se kandidatja _____ është e vetmja kandidate aplikuese nga Fushë Kosova, andaj, nisur nga pretendimi ankimor Kolegji ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të kandidatës në fjalë nga dhe ka konstatuar së e njëjta posedon Diplomën me numër 1162/14 të datës 30.09.2014 të lëshuar nga Kolegji AAB, më të cilën dëshmohet se ka të përfunduar studimet themelore për Administratë Publike dhe ka marrë titullin bechellor në Administratë Publike, ndërsa lidhur me përvojën pas diplomimit ka ofruar Referencën me numër protokollit 504 të datës 03.03.2015 të lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil më të cilin është vërtetuar së _____ ka kryer punë praktike në këtë Institucion nga data 19.12.2014 deri me 19.03.2015 (3 muaj) vërtetimin nr.protokollit A1-1596-3/14 të datës 13.12.2014 sipas të cilit e njëjta ka kryer punë praktike në Kolegjin AAB nga data 17.11.2014 deri me 13.12.2014 (27 ditë), sipas referencës së datës 21.09.2017 të lëshuar nga kompania "AL Trade" dhe pasqyrës së TRUST-it Pensional, _____ ka punuar në këtë kompani për periudhën dhjetor 2016 deri gusht 2017 (9 muaj), si dhe sipas Pasqyrës së Trustit e njëjta ka punuar në "Beko Invest" SHPK nga prill 2018 deri korrik 2019 (16 muaj), pra ankuesja kandidatja në fjalë ka përvojë punë pas diplomimit mbi dy vite (gjithsej 28 muaj e 28 ditë), dhe si rrjedhojë ky pretendimi i ankues është i pabazuar.

Po ashtu, Kolegji vlerëson së është i pa bazuar pretendimi ankimor i ankueses së Raporti Final i Komisionit Përzgjedhës nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit, sepse bazuar në nenin 34 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Raporti Final pas testim me shkrim dhe intervistës me gojë

përgatitet dhe nënshkruhet vetëm nga Kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës, ashtu siç është vepruar me rastin e Raportit Final të datës 23.09.2019 të Komisionit Përzgjedhës për pozitën "Zyrtar Për Azil" në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me zhvillimin e procedurës rekrutuese si dhe pas trajtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar Për Azil në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan, është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1,2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/1–149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: "*Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 329/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtares
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-ës